

Llokman Mirtezani, PhD<sup>1</sup>

UDC: 347.235

349.418

## **EVROPIANIZIMI, INTEGRIMI EVROPIAN DHE GLOBALIZIMI**

### **ЕВРОПЕАНИЗАЦИЈАТА, ЕВРОПСКАТА ИНТЕГРАЦИЈА И ГЛОБАЛИЗАЦИЈАТА**

### **EUROPEANIZATION, EUROPEAN INTEGRATION AND GLOBALISATION**

#### **ABSTRACT**

This paper is concerned with developing a conceptualization of Europeanization and providing an understanding of its ongoing dialectical relationship with European integration. The paper is defining the Europeanization that refers to the interaction of the European Union, its member states, and the potential countries to join the EU. Europeanization and the European Integration are related concepts, which result in convergence, and the process of homogenizing between the member states.

Europeanization is conceptualized as the process of adopting European Union directives, regulations and institutional structures to the domestic level.

There are also problems regarding the differences and similarities between Europeanization and European integration and whether the former offers anything new to the study and analysis of the EU. And both these concepts are related with the Globalization process.

---

<sup>1</sup> Doktor shkence. Kolegji Dardania, Prishtinë, Kosovë (llokmanmirtezani@kolegji-dardania.com)

Thus, Europeanization and European Integration are broad concepts which concern many aspects of the relations between the Community and its constituent states, and should be at least useful in explaining some aspects.

Keywords: Europeanisation, European integration, globalization, basic freedoms.

## **NOCIONI I EVROPIANIZIMIT DHE INTEGRIMIT EVROPIAN**

*Evropianizimi* në kuptimin e ngushtë sugjeron një përgjigje ndaj politikave të Bashkimit Evropian, që përhapet brenda shteteve anëtare si dhe shteteve aplikante të BE-së. Në raste të caktuara ky ndikim shkon edhe përtej asaj që mbërthen në vete BE-ja, pasi që ka ndikim edhe në kulturën e kolonive që dikur ishin nën pushtetin fuqive evropiane.

Gjithashtu evropianizimi paraqet proceset direkte dhe indirekte në mes shteteve anëtare të BE-së dhe ndërmjet BE-së dhe shteteve anëtare individuale, ku aktorët, politikat dhe institucionet ndikojnë në njëri-tjetrin në mënyrë strukturore, ideologjike dhe procedurale.<sup>2</sup>

Një definicion tjetër thotë se evropianizimi është një masë e caktuar e fuqisë së shpërndarë në mes BE-së dhe qeverive nacionale.

Deri më tani evropianizimi konceptualizohet si kapaciteti i vendeve për të akomoduar kornizën institucionale të Bashkimit Evropian, përvetësimin e normave dhe vlerave të Evropës, siç janë: demokracia, sundimi i ligjit apo drejtat e njeriut, identifikimi me të kaluarën e Evropës. Imperativi i parë ka të bëjë me adaptimin institucional në fushën e politikës, kurse direktivat apo vlerat bashkë me identitetin më shumë pasqyrojnë pjesën sociologjike, psikologjike dhe antropologjike.

*Integrimi evropian* është një projekt me rëndësi të madhe ekonomike për konsumatorët dhe biznesin në Evropë. Ai ka sjellë hapjen graduale të kufijve për lëvizje të lirë të mallrave, shërbimeve, njerëzve dhe kapitalit (katër liritë themelore të BE-së). Me këtë është mundësuar krijimi i Tregut të Vetëm në vitin 1992, i cili tani përfshin diku 500 milionë konsumatorë dhe rreth 21 milionë sipërmarrje. Qëllimet e këtij tregu janë të krijojë klimë të përshtatshme për biznes përtej kufijve me anë të politikave të përbashkëta nacionale dhe evropiane.

---

<sup>2</sup> Palmowski, J. The Europeanisation of the Nation-State. *Journal of Contemporary History*, 2011.

Evropianizimi në biznes u referohet të qenurit dhe të bërit më evropian dhe mund të lidhet me mjedisin e kompanisë (firma) dhe vetë kompaninë.<sup>3</sup>

Evropianizimi në mjedisin e biznesit manifestohet përmes urgjencës për mjedisin e biznesit evropian homogjen, që përbën një arenë me rregulla dhe standarde të përbashkëta, si dhe një shkallë e caktuar e konvergencës për preferencat e konsumatorëve. Evropianizimi i vetë firmës është zgjerimi në fushën gjeografike në regjionin evropian, për të inkorporuar integrimin. Ky është integrimi i operacioneve të firmës dhe politikave biznesore në një mënyrë të standardizuar nëpër Evropë.

Favoret nga ky integrim i korporatave janë në zvogëlimin e harxhimeve, heqjen e harxhimeve shtesë, ekonominë stabile, transferimin e praktikave më të mira dhe përshtatshmërinë e politikave.

Racionalja e kompanive për t'u evropianizuar qëndron në kërkimin e përparësive konkurruese duke përdorur resurset dhe mundësitë e tregut brenda Tregut të Brendshëm Evropian.

## **EVROPIANIZIMI, INTEGRIMI EVROPIAN DHE GLOBALIZIMI**

Sipas studiuesit Kevin Featherstone evropianizimi është proces që ndikon në mënyrë të ndryshme mbi aktorët dhe institucionet, idetë dhe interesat. Pra, evropianizimi është proces i cili është më inkluziv në krahasim me integrimin evropian.

Evropianizimi në fakt është një lloj force e shteteve anëtare në konkurrencën ndërkombëtare për kapitalin dhe tregjet e prodhimeve, por në të njëjtën kohë siguron interesat ekskluzive të tyre në BE, që arrihet përmes integritit monetar dhe tregut të vetëm.<sup>4</sup>

Me këtë arrihen rregulloret dhe përkushtimi për projekte të përbashkëta politike. Struktura institucionale të BE-së tejkalon autoritetet e tjera ekonomike, ndërkombëtare apo regjionale.

Lidhja në mes regjionalizimit dhe globalizimit është korniza normative e evropianizimit. Pra, evropianizimi kuptohet si një gjendje që shërben për përhapjen më të ngushtë të globalizimit.

---

<sup>3</sup> Harmsen R. and Thomas M., *Europeanisation: institution, identities and citizenship*, Yearbook of European Studies. Editions Rodopi B.V., Amsterdam-Atlanta, GA, 2000.

<sup>4</sup> Schmidt, V.A. (2002). *Europeanisation and the Mechanics of Economic Policy Adjustment*. *Journal of European Public Policy*.

Organizatrat regjionale sikurse BE-ja janë të dëshirueshme përderisa dallojnë nga fuqitë e një shteti, me çka kapaciteti operativ i BE-së është në shërbim të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Organizatës Botërore Tregtare ku imponohen disa praktika të mirëqenies dhe tregjeve të punës. Me këto standarde perëndimore evropianizimi shihet si një perspektivë e cila ndihmon globalizimin. Nga kjo mund të nxjerrim përfundimin e një modeli të ri të qeverisjes të bazuar mbi parimet e barazisë, vetëqeverisjes dhe demokracisë direkte. Pra, evropianizimi mund të llogaritet si një filtër i liberalizimit të mëtutjeshëm apo si mjet për globalizim.

Nga krejt kjo mund të konkludojmë se të dyja evropianizimi dhe globalizimi kanë vazhdimësi të njëjtë të politikëbërjes e cila përhapet nga një shtet, përmes hapësirës evropiane, deri në nivel global.<sup>5</sup>

Gjithashtu mund të tërhiqet një paralele në mes supranacionalizimit të politikave të shteteve anëtare dhe lëvizjeve të globalizimit të cilat duket se ndjekin parimet e njëjta sistematike, siç janë rregullat e tregtisë së lirë, demokracinë liberale apo liberalizimin.

**Faktorët që ndihmuan dhe ndikuan në evropianizimin** e shteteve janë globalizimi dhe integrimi evropian. Globalizimi dhe integrimi evropian kanë gjithashtu kanë ndikuar të sjellin në bashkimin e shteteve për politika të mëdha, kurse në ndërkohë të ruajnë sovranitetin tradicional dhe modern.

Evropianizimi i shteteve anëtare ka rezultuar më evropianizimin e politikës së jashtme nacionale, që është bërë e njohur viteve të fundit.

Ka disa procese dhe vendime që kanë sjellë dhe përshpejtuar në evropianizimin, edhe atë, institucionalizimi tregut të vetëm evropian. Kjo është arritur përmes direktivave të BE-së, normave dhe jurisprudencës, e që është zhvilluar shumë që nga Akti i Vetëm Evropian nga viti 1986.

Si arsye tjetër mund të përmendet dhe Bashkimi monetar dhe ekonomik. Kjo është arritur përmes EMU-s, pra krijimin e valutës së vetme evropiane, i cila ka rritur ndërvarësinë dhe bashkëpunimin në sfera tjera politike. Me këtë ka ardhur në krijimin e euro-zonës, që nuk ishin të limituara vetëm në politiken nacionale, por gjithashtu kanë ndikuar në procesin se si janë formuluar politikat nacionale.

<sup>5</sup> Wallace, H. (2000b). 'The Institutional Setting: Five Variations on a Theme'. In H. Wallace & W. Wallace (Eds.), *Policy-Making in the European Union*, 3-37. Oxford: Oxford University Press.

Në procesin e evropianizimit ka ndikuar dhe konkurrenca e rregulluar, që ka lidhje direkte me tregun e vetëm. Shumë politikanë evropianë konsiderojnë se tregu i vetëm shërben si proces me anë të cilit vendet evropiane sigurojnë konkurrencën brenda një konteksti më të gjerë të Bashkimit Evropian.

Faktori tjetër vjen nga efekti i procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian. Ndër më të rëndësishme janë kriteret e Kopenhagës nga viti 1993, që kanë kontribuar në një masë të madhe në evropianizimin. Kështu që vendet kandidatë duheshin të përshtaten dhe përmbushin standardet vitale të BE-së që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, demokracinë, drejtat e njeriut dhe përshtatje ekonomike.

Deri në këtë kohë, pra deri në vitin 2004 me zgjerimin e “madh” efekti i evropianizimit kishte efekt të jashtëm, kurse pas këtij rasti efekti i evropianizimit u shndërrua në diçka interne.<sup>6</sup>

Këto janë katër faktorët që në masë të madhe kanë ndikuar në evropianizimin dhe politikën e jashtme të shteteve anëtare dhe shteteve që aspironin të bëhen pjesë e Bashkimit Evropian.

**Politika konkurruese brenda Bashkimit Evropian** - rregulla e tregut brenda BE-së është një arsye e thellë ekonomike që përmban dështimet tregtare për të arritur një mirëqenie sociale, edhe atë sigurimin shëndetësor, siguria, mjedisi dhe mbrojtja e konsumatorit, si dhe për të larguar barrierat për lëvizje të lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve. Mjedisi i rregulluar i BE-së e bën atë lokacion atraktiv për biznesin: me rregulla që kanë për qëllim të sigurojnë bërjen e biznesin në tërë Tregun e Brendshëm dhe politikë të rreptë konkurruese që mbron nga abuzimi i tregut dhe çrregullimet. Megjithatë, BE-ja akoma nga disa studiues shihet si e tepruar me rregulla nga një trup legjislativ dhe rregullues për sa i përket sigurisë, shëndetit dhe standardeve për mbrojtje të mjedisit.

Si favor më i rëndësishëm që vjen nga mjedisi rregullator i BE-së dhe si aspekt pozitiv është qëllimi i saj për të krijuar një hapësirë në tërë Bashkimin Evropian. Në bazë të parimeve për njohje reciproke, që është pjesë në shumicën e politikave, nuk ka nevojë për harmonizim të të gjitha legjislacioneve nacionale të shteteve anëtare. Nga kjo mallrat dhe shërbimet e shitura në një shtet anëtar nuk mund të ndalohet nga tjetri. Kjo mundëson, pra njohja reciproke, dallimet në mes

<sup>6</sup> Simon J. Bulmer and Claudio M. Radaelli, (2004)

specifikacioneve të legjislacioneve nacionale të mos paraqesin pengesa për tregti të lirë, përderisa qëllimet e rregullave nacionale në shtete të ndryshme janë ekuivalente. Për biznesin kjo do të thotë se mjafton të përshtatet me rregullat e vendit të origjinës (në rast eksporti) për të prodhuar dhe shitur nëpër BE, edhe pse dispozita specifike të legjislacionit nacional dallojnë në mes shteteve anëtare.

Integrimi evropian gjithashtu ka siguruar që të mund të themelohen sipërmarrje në tërë Bashkimin Evropian. Kjo më së miri është mundësuar përmes pikave elektronike një sportel (portale për e-qeverisje) në të gjitha shtetet anëtare në vitin 2009, ku janë thjeshtësuar procedurat për të filluar biznes dhe për të kompletuar të gjitha formalitetet, siç është autorizimi dhe njoftimi “online”.

Me Aktin për biznese të vogla për Evropë dhe iniciativa tjera të Komisionit Evropian kostoja mesatare dhe koha për krijimin e një kompanie ka rënë nga 823 euro dhe 24 ditë në vitin 2002, në 397 euro dhe 6,5 ditë në vitin 2011. Tash synimi është të bjerë në 3 ditë dhe në më pak se 100 euro.

Integrimi evropian është një proces i shoqëruar me zhvillimin e një politike konkurruese të qartë për të siguruar funksionim të mirë të Tregut të Brendshëm dhe për të ndaluar sjelljen antikonkurruese të firmave, pra abuzimin e pozitave dominuese në treg që çon në largimin e konkurruesve. Kjo arrihet përmes sanksionimit të sjelljes antikonkurruese nga ana e Komisionit Evropian ndaj kompanive dhe imponon kontrollin e bashkimeve të kompanive që mund të çon në krijimin apo forcimin e aktorëve dominues në treg.<sup>7</sup>

Sigurimi i drejtësisë dhe konkurrencës në Tregun e Vetëm është një favor direkt për kompanitë që gëzojnë më pak apo fare nuk kanë barriera, e që janë të mbrojtura nga marrëveshjet e fshehta të konkurrentëve që kanë për qëllim kontrollin mbi çmimet apo të ndajnë tregjet.

Me anë të parimit për njohje reciproke mundësohet qasje e ligjshme e bizneseve në të gjitha tregjet nacionale në Bashkimin Evropian përderisa respektohen ligjet për njohje. Bizneset e vogla njohin rregulla dhe procedura për themelim dhe për të përfituar në tërë BE-në.

Politika e konkurrencës gjithashtu siguron në BE hapësirë të barabartë për të gjithë subjektet biznesore.

---

<sup>7</sup> European Commission, Summaries of Legislation: Competition: [http://europa.eu/legislation\\_summaries/competition/firms/index\\_en.htm](http://europa.eu/legislation_summaries/competition/firms/index_en.htm), qasur më 10.01.2018.

Këto janë disa standarde që duhet të përgatiten për t'u ballafaquar shtetet aspirante për anëtarësim në BE, respektivisht të dinë të drejtat dhe përgjegjësitë në rast të çrregullimeve të treg dhe konkurrencë.

Pra, si rekomandim për ndërmarrje të dhënë është një analizë e thellë e biznesit të saj specifik për benefitet apo përfitimet e saj, si dhe pengesat në aspektin e integritimit evropian.

Mjedisi rregullator në tërë BE-në siguron katër liritë themelore të lëvizjes dhe konkurrencën brenda tregjeve evropiane, por disa kompani akoma ballafaqohen me barriera në tregti dhe bien viktimë e abuzimit apo keqpërdorimit të pozitës dominuese të liderëve tregtarë.

Në raste të tilla të tilla kompanitë “viktima” për të ndaluar tregun e padrejtë dhe praktikën e padrejta antikonkurruese duhet të drejtohen deri tek Drejtoria e Përgjithshme Tregtare apo Drejtoria e Përgjithshme për Politika Konkurruese e Bashkimit Evropian.<sup>8</sup>

Këto shërbime të Komisionit Evropian janë përgjegjëse për hetimin e rasteve të lartpërmendura. Komisioni Evropian ka të drejtë në bazë të Traktatit të zbatojë rregulla ndaluese dhe ka të drejta hetuese si rezultat i asaj që politika tregtare dhe konkurruese janë kompetenca ekskluzive të Bashkimit Evropian.

*Integrimi i tregut për mallra* – Tregu i brendshëm i mallrave është arritje e cila ka filluar avancimin e integritimit ekonomik evropian. Sot BE-ja është ekonomia më e madhe në botë, një treg i madh me shumë mundësi për ekonominë dhe bizneset. Në të njëjtën kohë hapja tregjeve nacionale të shteteve anëtare për tregti të lirë të mallrave ka paraqitur një sfidë të rëndësishme për të rritur konkurrencën për sipërmarrjet, në veçanti sipërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Si favor nga lëvizja e lirë e mallrave është se kompanitë që prodhojnë mallra të transportueshme dhe të tregtueshme kanë mundësi shumë më të mëdha. Me këtë arrihet integrimi i 500 milionë konsumatorëve potencial për aktivitet në relacionin biznes konsumator, dhe ku 21 milionë sipërmarrje kanë mundësi për aktivitete biznes me biznes për të arritur ekonomi të mëdha, në veçanti përmes kompanive të mëdha.

Kjo është arritur me shkurtimin e kontrolleve kufitare dhe me këtë është zvogëluar edhe koha dhe kostoja e dërgimit të mallit. Kjo ka ndikuar edhe në organizimin më efikas për zinxhirët e furnizimit.

Me integrimin evropian apo evropianizimin e kompanive është rekomanduar që kompanitë të gjejnë vende dhe lokacione ku kanë

---

<sup>8</sup> Suder G., *Doing Business in Europe*, 2nd Edition, Sage Publications, London, 2008.

resurse të disponueshme më të konvencueshme, për të transportuar resurset e tjera apo mallrat e nevojshme brenda tregut evropian.

Me këtë kompanitë evropiane, të shteteve anëtare, kanë një përparësi mbi kompanitë joevropiane që eksportojnë në Evropë, kështu që mund të transportojnë faktorët prodhues, mallrat apo produktet gjysmë-finale në mes shteteve anëtare pa ndonjë tarifë apo pagesë shtesë brenda vetë BE-së.

Këtu ka ndikuar shumë edhe largimi i kufijve fizikë brenda Bashkimit Evropian, ashtu që kompanitë mund të rrisin konkurrencën duke reduktuar kostot e tyre logjistike.

Në integrimin edhe më të thellë apo globalizimin e tregut evropian ka ndikuar edhe Tregu i Vetëm me valutën e vetme evropiane, e që ka rritur transparencën nëpër hapësirën evropiane, për derisa liberalizimi i shumë sektorëve ka ulur çmimet. Me këtë është arritur konkurrenca e çmimit, kurse bizneset është dashur të fokusohen në kualitet, performancë, efikasitet dhe inovim.

*Participimi në standardizimin evropian* - standardizimi është proces në BE dhe i cili nuk i mbyllur për biznesin. E kundërta, secila industri, sipërmarrje e vogël apo e mesme që është e interesuar për të zhvilluar një standard, mund ta bëjë atë. Qasja më e lehtë për procesin e standardizimit për biznesin evropian realizohet përmes Organeve Nacionale të standardizimit që janë anëtarë apo filiale të Komitetit Evropian për Standardizim.

Përfshirja në procesin e standardizimit nuk paraqet vetëm një mundësi për të ndikuar në përmbajtjen e standardeve ashtu që ato bazohen në nevojat e tyre biznese, por gjithashtu një praktikë e ndarjes së njohurive e cila mundëson për të parashikuar trendet e ardhshme në industrinë e tyre.

*Integrimi i tregut për shërbime* - Shërbimet paraqesin diku 70% të GDP-së së BE-së. Shërbimet që janë potencialisht të tregtueshme në tregun e brendshëm mund të llogariten në diku 40% të GDP-së, e që është dyfishi i tregtisë së mallrave brenda Bashkimit Evropian.

Tregu i shërbimeve në BE është esencial për kompanitë, pasi që ato përdorin shërbimet si input dhe japin shërbimet si output. Integrimi evropian i tregut të shërbimeve ka sjellë disa favore për biznesin, edhe atë: lehtësimin e dispozitave për kalimin e kufijve për shërbimet, dhe themelimin e pikave njëkontaktëshe për hapur prokurim publik përtej kufijve.



Si favore të lëvizjes së lirë të shërbimeve mund të numërohen: direktiva për shërbime horizontale që ka për qëllim të largoj ngarkesat e pajustificueshme për lëvizjen e lirë të shërbimeve dhe themelimi i pikave të vetme për dhënësit e shërbimeve; prokurimi publik përtej kufijve<sup>9</sup>; liberalizimi i energjisë, transportit dhe sektorit të telekomunikacionit-ulja e çmimeve; investime infrastrukturore të rrjeteve trans-evropiane përmes fondeve strukturore dhe Bankës Evropiane për Investim.

Megjithëse, si i kundërt me tregun e mallrave, tregu i brendshëm i shërbimeve akoma nuk mund të llogaritet si i kompletuar apo plotësisht konkurrues në disa fusha të caktuara. Si probleme që akoma ekzistojnë dhe janë të vazhdueshme mund të përmendim disparitetin e çmimeve, si dhe kërkesat e ndryshme rregullatore të shteteve anëtare. Duke qenë të vetëdijshme për këto probleme shtetet anëtare dhe kompanitë që kanë për qëllim evropianizimin u rekomandohet të lokalizojnë problemet dhe të drejtojnë aktivitetet e zinxhirit të vlerës në shtetet anëtare për të minimizuar koston.

*Lëvizja e lirë e njerëzve dhe punëtorëve* - Themelimi i lëvizjes së lirë të njerëzve ishte një nga qëllimet kryesore të BE-së për dy arsye. Njëra, mundësia për jetuar dhe punuar në cilindo shtet anëtar krijon dhe ndihmon identitetin evropian të qytetarëve, dhe e dyta ushqen projektin e integritimit evropian të perceptuar nga njerëzit e saj.

Në anën tjetër mobiliteti gjeografik i punës ka potencial për të rritur efikasitetin e tregu të punës dhe të zvogëlon papunësinë, me një përshtatje më të mirë të kërkesës dhe ofertës së punëtorëve në nivele të ndryshme të kompetencës. Lëvizja e lirë e punëtorëve në nivel evropian është përforcuar përmes njohjes reciproke të kualifikimeve profesionale dhe rritjes së kompetencës së njerëzve. Por, favorët e lëvizjes gjeografike në Evropë akoma nuk janë shfrytëzuar sa duhet, pasi që punëtorët kryesisht janë imobil dhe jofleksibil.

Zgjedhja e punës gjithashtu mund të ndikoj në lokalizimit e kompanisë, pasi që fuqia punëtore evropiane është statike. Kur një kompani vendos të themeloj një filiale tjetër, ajo duhet të marrë parasysh fuqinë punëtore në vendin korrespondues. Nga kjo del që kompania duhet të ketë parasysh edhe kostot për komunikim, transport dhe këmbim të informatave në mes njësisve të ndryshme biznesore.

---

<sup>9</sup> European Commission, How the EU Single Market benefits you, DG Internal Market, Brussels 2010.

*Lëvizja e lirë e kapitalit* - Lëvizja e lirë e kapitalit duhet të ndihmon në themelimin e tregjeve dhe shërbimeve evropiane të integruara, të hapura, konkurruese dhe efikase.<sup>10</sup> Liberalizimi i plotë i lëvizjes së kapitalit si pjesë e Tregut të Brendshëm ka hyrë në fuqi nga 1 janari i vitit 1994, duke shoqëruar zhvillimin e Unionit Ekonomik dhe Monetar të dalë nga Traktati i Mاستrihtit.

Lëvizja e kapitalit mund t'u referohet operacioneve përtej kufirit duke përfshirë: investim të huaj direkt, investim në patundshmëri, investim në letra me vlerë, si dhe dhënies së huave dhe kredive.

Favoret kryesore të lëvizjes së lirë të kapitalit kryesisht qëndrojnë në kapitalin plotësues, aftësisë për të investuar jashtë vendit dhe në eliminimin e rreziqeve valutore.

*Të qasurit dhe lëvizja më e lirë e kapitalit në eurozonë*- për të shfrytëzuar favoret e valutës së vetme, pra zvogëlimin e riskut të këmbimit të valutës, kosto më të vogla transaksioni, treg më i madh, më pak pasiguri e tjera, kompanitë duhet të konsiderojnë të përdorin euron si valutë të tyre për transaksion dhe investim nëpër BE, edhe në rast se valuta e tyre vendore është e ndryshme.

Me harmonizimin gradual të rregullave financiare të tregut dhe lirisë për flukset e kapitalit, kompanitë në Evropë duhet të lëvizin kapitalin në ato pjesë të hapësirës me valutë euro ku mund të përdoret në mënyrë më efikase. Si shembull këtu mund të marrim, kompanitë mund të bartin kapitalin ku është më i favorshëm për ato, e një ndër ato vende së fundit është Luksemburgu si vend më i njohur në Evropë për të lëshuar obligacione private.

## CONCLUSION

Europeanization represents a specific process of the European integration.

The specialized literature and analyses confirm that through the Europeanization is being created and developed the foundation for systematic and institutional frame, which allows an analysis of the opportunity of political-administrative structure.<sup>11</sup>

<sup>10</sup> European Commission, Free movement of capital: [http://ec.europa.eu/internal\\_market/capital/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/internal_market/capital/index_en.htm) qasur më 13.01.2018

<sup>11</sup> Kaeding, M. 2004. "National administrative structures to transpose EU directives. Convergence to a common institutional model?", *Politicoogenetmaal*, 27-28 May, Antwerp, Belgium

The European integration process itself obliges the member-states to adopt the rules of the EU's game, whereas as most important is considered the Single European Market with its four fundamental moving freedoms.

Anyway, these fundamental freedoms according to this model of functioning can be considered as freedoms that guarantee and protect the equality for opportunity being offered within the European Single Market and the Europeanization of the business.

### **RECENSENTË:**

Dr.Sc. Muazam Halili - studime juridike, kolegji Dardania, Prishtine, Kosove, [muazamhalili@kolegjidardania.com](mailto:muazamhalili@kolegjidardania.com)

Dr.Sc. Fatos Rushiti - studime te sigurise, kolegji UBT, Prishtine, Kosove, [fatos.rushiti@ubt-uni.net](mailto:fatos.rushiti@ubt-uni.net)

### **LITERATURA:**

- Featherstone, K. & Radaelli, C. (Eds.) (2003). *The Politics of Europeanisation*. Oxford: Oxford University Press.

- Atkinson, Robert D. and Andes, Scott M., *The Atlantic Century: Benchmarking EU & U.S.*

Innovation and Competitiveness. European-American Business Council. July 2011.

- Mario Monti, *A New Strategy for the Single Market*, 2010.

- Dunning J. H. and Robson P., 'Multinational Corporate Integration and Regional Economic Integration.', in: *Journal of Common Market Studies*, Vol. 26, 1987.

- European Commission, Free movement of capital: [http://ec.europa.eu/internal\\_market/capital/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/internal_market/capital/index_en.htm) qasur më 13.01.2018

- European Commission, Summaries of Legislation: Competition: [http://europa.eu/legislation\\_summaries/competition/firms/index\\_en.htm](http://europa.eu/legislation_summaries/competition/firms/index_en.htm), qasur më 10.01.2018